



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1499/23 0 Datë: 27.10.23

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 117-të, të mbajtur më datë 20.10.2023, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Kolegjit AAB kampusi kryesor, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2023 - 30 shtator 2026):
 1. *Gjuha Gjermane - përkthim dhe interpretim, Bachelor Professional, 180 ECTS, me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji AAB kampusi kryesor që deri më datë 15.12.2023 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji AAB kampusi kryesor të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovet me vendim nga KShC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë - Kolegji AAB kampusi kryesor, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

1/2

Kolegji AAB kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Gjuha Gjermane - përkthim dhe interpretim, Bachelor Professional, 180 ECTS,</i>	Armend Bytyqi Miradije Myftaraj Shkurte Veliu Ajdini

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB kampusi kryesor.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; *Gjuha Gjermane - përkthim dhe interpretim, Bachelor Professional, 180 ECTS*, vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Frank Basner dhe Juraj Bogat është organizuar më 14.09.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht gjashtë (6) dhe Substancialisht një (1) standard të akreditimit.

Pas pranimit të raportit final të ekspertëve ndërkombëtarë për programin *Gjuha Gjermane - përkthim dhe interpretim, Bachelor Professional, 180 ECTS*, AKA menjëherë të njëjtin ka dërguar për shqyrtim në KShC.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 117-të, të mbajtur më datë 20.10.2023, ka shqyrtuar raportin final të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit të realizuar nga vizita e bërë Kolegjit AAB kampusi kryesor dhe duke u bazuar në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc./Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë